

NJË POEZI SHQIPE të paktën 3600 vjet e vjetër

NIKO STYLOS

Kjo poezi është shkruar në njërin anë të diskut të njohur me emrin Disku i Festos ose Faistos. Ky disk, që sot ndodhet në Muzeun Arkeologjik të Heraklionit të Kretës, u gjet nga arkeologu italian Luigi Pernier, më 3.7.1908, gjatë gërmimeve në pallatin e vjetër të Festos, i cili llogaritet se ishte në përdorim në periudhën kohore 1850 - 1600 p.e.r. Është një disk qeramike me diametër 158-165 dhe trashësi 16-21 milimetra dhe konsiderohet, nga vendi ku u gjet, se ruhej në arkivin e këtij pallati.

Për Feston, shkurt do të them, se ishte një nga qytetet më të rëndësishme të Kretës minoike gjatë mijëvjeçarit të dytë p.e.r., dhe sot është qendër (hapësirë) e shkëlqyer arkeologjike. Për emrin e tij, që konsiderohet paragrek dhe nuk ekziston asnjë shpjegim, unë besoj se e ka marrë nga hyu Ifestos (Ifaistos, Ἴφαιστος) me lënie jashtë (rënie) të gërmës nistore I (H).

Historiani Diodor Siquelioti apo Diodori nga Sicilia (5,78), themelues të Festos konsideron Minosin dhe të Homeri emrin e tij e gjejmë te *Iliada* (Kënga 2, vargu 648) dhe te *Odisea* (Kënga 3, vargu 296).

Sipas arkeologëve, epoka minoike fillon më 2.600 p.e.r. dhe pallati parë i Festos u ndërtua rreth vitit 2.000 p.e.r. me argolitodomi (αργολιθοδομή), siç e quajmë, domethënë me ndërtim muresh prej gurësh pa asnjë përpunim.

Disku i Festos



Ana e përparme (e parë)

Ana e pasme (e dytë)

Ky pallat u shkatërrua nga tërmeti rreth vitit 1730 p.e.r., dhe mbi gërmadhat e tij u ndërtua më madhështor, ku dhe ai u rrënuar nga zjarr rreth vitit 1600 p.e.r.

Ndërkohë, me metodat e reja të matjes së vjetërsisë së objekteve, datohet dhe prodhimi i diskut, shpëtimi i të cilit konsiderohet fatmirësi në fatkeqësi, se u ruajt pas një pjekjeje në një temperaturë shumë të lartë gjatë zjarrit, që dogji pallatin e Festos.


Studuesit që u morën me të na thonë se konsiderohet monumenti i parë i tipografisë (i shtypshkrimit), se teksti u shtyp apo më mirë u vulos në dy pllaka prej argjile të njomë, të cilat në vijim u ngjitën në një. Mbi të gjitha na thonë edhe se është unik për sa i përket mënyrës së grafisë (shkrimit) dhe simboleve të veta; ndërsa qëllimi i ndërtimit të tij dhe prodhuesi i tij, konsiderohen një nga misteret e shumta të arkeologjisë




Festos

Fragmente të brendshme të pallatit

Ngaqë besoj se këta studiues nuk janë marrë dhe aq shumë me këtë temë, po jap dhe paraqitjet e lashta vijuese, ku kemi dhe dy nga simbolet e Diskut të Festos, nga ku mund të them se mëtimi që këto simbole nuk janë gjetur asgjëkund, nuk është i saktë.



Në të parën e këtyre paraqitjeve, ku kemi një monedhë nga Kerkyra (Korfuzi), të quajtur dhe ndryshe ishulli i Epirit, siç shikojmë ekziston dhe simboli , të cilin te Disku i Festos e gjejmë

madje katër herë të shkruar .

Në paraqitjen e dytë, ku kemi një hajmali të besimit (fesë) të quajtur



Monedhë e Kerkyrës e periudhës 350-270 p.e.r.

në latinisht të Abrax-it, në qendër të mbishkrimit që mban Abrax-i, kemi dhe simbolin , që e gjejmë dhe te Disku i Festos dhe madje dy herë të shkruar .



Hajmali (nuska) Abrax

Lidhjen e Kerkyrës së stërlashtë me gjuhën arvanitase dhe në përgjithësi me gjuhën e shqiptarëve, e gjejmë në historinë e këtij ishulli, gjersa sipas shkrimeve historike, para vendosjes së të quajturve kolonë të parë grekë nga Eritrea e Eubesë në shek. e 8 apo të 9 p.e.r., banohej nga ilirë.


Për të vërtetuar origjinën arvanitase të trupit të njeriut me kokë këndesi, një figurë fantastike, zgjedha dhe hajmalinë e dytë të këtij besimi të karakterizuar nga të krishterët e sotëm satanik dhe i mallkuar, ku siç shikojmë, kemi të shkruar me alfabetin grek emrin arvanitas BPACA (ΒΡΑΨΑ, Vrasa), që do të thotë vrasës.

Gjatë kërkimit për më shumë të dhëna, zgjedha dhe paraqitjen e mëposhtme, ku për burrin me këndesin në mburojë kemi emrin TYΔΥΣ (TYDHYS).

Për TYDHYS-in, që në greqisht e quajmë Tidheus (Τιδεύς), na është e njohur se ishte bir i Oineas (Οινέα), mbretit të Etolisë (Ατωλίας), që ishte një vend në bregdetin e Detit Jon. Ndërsa shpjegimin se përse mori emërtimin Vrasa (Βράσα) apo Vrasës, e gjejmë te Apollodori, ku lexojmë:



"Kur Tidheu (Tideu) u rrit dhe u bë një djalë trim, u internua, sepse vrau, siç thonë, vëllain e Oineas Alkanthin, apo siç thotë autori i Alkmeonidës, ngaqë vrau bijtë e Melanosi), Fineun, Eurilaun, Yperlaun, Antiokun, Eumidin, Sternopin, Ksanthipin dhe Stenelaun, që komplotonin kundër Oineas, apo më në fund, siç thotë Ferekidisi, se vrau vetë vëllanë e tij, Olenian. Dhe meqë Agriosi (Egri) hapi gjyq kundër tij, u strehua në Argos pranë Adrastit (Αδραστο)... (Apoll. VIII. 5).

Ngaqë te monedha nga Kerkyra me simbolin , nga ana tjetër kemi lopën që i jep qumësht vicit të vogël, simbol që e gjejmë në më të shumtat e monedhave të të quajturave koloni të saj, domethënë të Apollonisë dhe Epidamnit apo Dyrrahit të mëvonshëm, zgjedha dhe dy statirët e argjendit të mëpasshëm nga Karistoja (Κάρυστο) e Eubesë, te të cilët kemi po të



Statu i argjendit nga Karistoja e Eubesë, shek. i 3-të p.e.r.

Statu i argjendit nga Karistoja e Eubesë, rreth viteve 400-370 p.e.r.

njëjtën paraqitje.

Duke ditur se edhe sot në Karisto flasin arvanitisht, dhe duke marrë këndesin, apo gjelin apo kokoshin, që gjendet në anën tjetër të të dy këto monedha, si simbol etnik i banorëve të Karistos, atëherë do të mund të thosha se alfabeti, të cilin e kemi të shkruar te shishja e bojës e mëposhtme në formë këndesi, nëse nuk është alfabeti i stërlashtë i Karistos, të paktën është alfabet që mund ta përdorte dhe ky qytet i lashtë.

Shishja e bojës e Viterbos

Ky objekt qeramike, i tipit të famshëm të qeramikës së teknologjisë "bucchero", që është karakteristik për ngjyrën e zezë të ndritshme dhe për paretet e holla, është gjetur në Viterbo të Tirrenisë dhe kronologizohet i shek. të 7 p.e.r. dhe sot ndodhet në Metropolitan Museum of Art të Nju-Jorkut.

Teksti i Diskut të Festos, i cili është shkruar në radhë (trajtë) helikoidale (spirale) me figura simbole, fillon nga të



Α Β Γ Δ Ε Ζ Η Θ Ι Κ Λ Μ Ν Ξ Ο Ρ Σ Τ Υ Φ Ψ Ω

Alfabeti i shishes së bojës nga Viterboja.

dyja anët në qendër dhe shkon për nga jashtë, në një mënyrë grafie si e sotmja, domethënë me shkrim me drejtim nga e majta në të djathtë. Vërtetimin e kësaj mënyre shkrimi, e kemi shumë mirë te të gjashtë


simbolet me paraqitje njerëzish:




ku siç shikojmë se të gjitha shohin për nga e djathta.

Për vulosje janë përdorur në tërësi 46 vula me simbole figura të ndryshme dhe në shumatore me to kemi 241 vulosje, 123 në të quajturën nga unë ana e parë dhe 118 te tjetra.

Ngaqë numri i këtyre 46 simboleve apo figurave, që secila shqiptohet si dhe tingulli i asaj që pasqyrohet, nuk ishte i mjaftueshëm për të dhënë gjuhën arvanitase, krijuesi i këtij alfabeti, me katër nga këto simbole, plotësoi edhe 7 të tjera me të kthyer në vulosje apo në grafinë e figurës së tyre, duke bërë në tërësi (shumatore) simbolet apo shkronjat e tij 53.

Të katër këto simbole janë: 

të cilat të shkruara i gjejmë dhe 



Te tabela e mëparshme, të cilin unë e quaj tabelë e alfabetit të Diskut të Festos, jap të gjitha ato simbole me radhën që i gjejmë, duke marrë si

1		4	12		19	23		2	34		5	45		2
2		2	13		3	24		2	35		1	46		4
3		4	14		10	25		6	36		6	47		5
4		11	15		6	26		1	37		1	48		2
5		6	16		2	27		6	38		3	49		2
6		2	17		1	28		1	39		4	50		1
7		4	18		2	29		4	40		3	51		1
8		11	19		1	30		18	41		1	52		1
9		2	20		12	31		6	42		2	53		1
10		13	21		4	32		2	43		6			
11		17	22		3	33		1	44		1			

të parë anën e sipërpërmendur, duke i shtuar madje edhe një shtyllë, ku jap dhe se sa herë secilin nga këto simbole e kemi të shkruar në tërësi.

Duke arritur në përfundimin se Disku i Festos është shkruar në arvanitisht, nisa të merrem me alfabetet e ndryshme të kësaj gjuhe që janë ruajtur. Ndërmjet tyre, që janë jashtëzakonisht të shumta, gjeta dhe një, i cili edhe ai ka 53 germa, domethënë sa alfabeti i Diskut të Festos, dhe që në Epir është i njohur me emrin "Alfabeti i Dhaskal Thodh".

Ky alfabet, që për mua është më i përsosuri për interpretimin e gjuhës arvanite dhe në përgjithësi të dialektit toskë, siç e emërtojnë albanologët, në bibliografinë e Europës Perëndimore e gjejmë me emrin "Alfabeti i Elbasanit" dhe nga libri "Das Buch der Schrift" i austriakut Carl Faulmann, po jap në fotokopje dhe tabelën e mëpasshme me titullin "Schrift von Elbassan".

Emërtimin "Alfabeti i Elbasanit" e ka marrë se Elbasani është vendi

SCHRIFT VON ELBASSAN.									
Zeichen	Wert	Zeichen	Wert	Zeichen	Wert	Zeichen	Wert	Zeichen	Wert
v	a	l	ts	s	r	h	ci	z	o
i	e	7	ds	r	e	v	7	o	l
i	i	z	nds	f	r	y	ps	l	mb
o	o	l	w	v	b	e	h	u	p
o	u	H	i	d	m	x	x	v	u
h	a	d	r	o	y	z	q	l	v
)	s	s	k	h	z	l	t	g	ds
s	s	c	k	k	u	l	d	g	ndz
z	dz	8	ks	h	z	xx	nd	5	st

ku është gjetur apo më mirë është ruajtur. Gjermani Johann Georg von Hahn, që u përket studiuesve të mirë në lëmenjtë e kërkimeve të gjuhës, folklorit dhe gjeografisë të shekullit të mëparshëm, këtij alfabeti i kushton një kapitull të tërë te libri i "Albanesische Studien". Dhe në një artikull të Kostandin Kristoforidhit me titull "Doktorit von Hahn", dorëshkrimi i të cilit

